

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA****AC-I-23-0010****Në ankesën e****M M**, Gjilan.**Paditësi/Ankuesi****kundër****E paditura**

NSH Industria e Baterive "IBG" (Në likuidim), Gjilan, e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, Rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakrishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Agron Hoxhaj gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-13-2081 të datës 11 nëntor 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 11 janar 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e paditësit është pjesërisht e bazuar.**
- 2. Ndryshohet pjesërisht Aktgjykimi i shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-13-2081 i datës 11 nëntor 2022.**
- 3. Obligohet AKP-ja-Autoriteti i Likuidimit që ti paguaj paditësit në emër të pagave të papaguara për periudhën mars 2004-dhjetor 2006, shumën prej 3,060.00 euro, dhe interesin ligjor prej 10% në shumë**

prej 306.00 euro, si dhe ti kompensohet pagesa e taksës gjyqësore për ankesën në shkallën e I-rë, në shumë prej 30 euro, të cilat shuma do të paguhen sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

4. Vërtetohet pjesa tjetër e Aktgjykimi të shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-13-2081 i datës 11 nëntor 2022, për pjesën e kërkesës për paga për periudhën dhjetor 2003-shkurt 2004.

5. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 30 shtator 2013, përmes postës paditësi e ka dorëzuar një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit të NSH Industria e Baterive "IBG" në Gjilan, GJI058-0054 të datës 13 shtator 2013, me të cilën ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa e paditësit për kompensimin e pagave të papaguara për periudhën dhjetor 2003-dhjetor 2006 në shumë prej 3,790,00 euro, me arsyetimin se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të punës së bashkuar. Paditësi në ankesë e kundërshton konstatimin e Autoritetit të Likuidimit se kërkesa për paga është parashkruar. Ai pohon se ishte pjesë e Padisë kolektive të punëtorëve që ishte dorëzuar në Gjykatën Komunale në Gjilan me datë 20 mars 2007, dhe se kjo padi e ka ndërprerë parashkrimin e kërkesës. Tutje Ai pohon se procedura lidhur me këtë padi ka përfunduar me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Gjilan C.nr.147/07 të datës 14.04.2011. Tutje ai pohon se ka punuar në NSH në periudhën kur ai i kërkon pagat dhe se NSH-ja i ka mbetur borxh prej 3,790,00 euro. Bashkë me ankesë paditësja dorëzon vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, kopjen e Librezës së punës e mbyllur me datë 22 maj 2012, kopjen e Letërnjoftimit, një kopje të Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Gjilan C.nr.147/2007 i datës 14.04.2011, dhe Njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës.

Me datë 13 nëntor 2017, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS mbrojtjen në ankesë. Në mbrojtjen në ankesë AKP-ja ka pohuar se kërkesa për paga të papaguara me

numër GJI058-0054, është parashkruar pasi që paditësi nuk ka dëshmuar që ai ka ndërmarr ndonjë veprim për të ndërprerë afatin e parashkrimit. Kërkesa për paga për periudhën dhjetor 2003 deri dhjetor 2006 është parashkruar dhe se koha e parashkrimit është 3 vjet, ashtu që kërkesa është parashkruar në vitin 2006. Tutje AKP-ja pohon se Padia kolektive e dorëzuar në DHPGJS me datë 13 mars 2007, nuk e ka ndryshuar këtë përfundim që kishte arritur Autoriteti i Likuidimit. Prandaj nga këto arsye Autoriteti i Likuidimit me të drejtë e kishte refuzuar kërkesën si të pavlefshme në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Me datë 04 dhjetor 2017, paditësi e dorëzoi një parashtresë në DHPGJS dhe përgjigjet në mbrojtje në ankesë të AKP-së. Në këtë parashtresë ai përsëritë pohimin se ishte pjesë e Padisë kolektive të punëtorëve që ishte dorëzuar në DHPGJS me datë 13 mars 2007, dhe se kjo padi eka ndërprerë parashkrimin e kërkesës. Tutje Ajo pohon se procedura lidhur me këtë padi ka përfunduar me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Gjilan C.nr.147/07 të datës 14.04.2011, ndaj të cilës AKP-ja ka bërë ankesë dhe procedura lidhur me këtë ankesë nuk ka përfunduar, andaj Autoriteti i Likuidimit nuk ka patër të drejtë të refuzoj kërkesën për shkak të parashkrimit.

Me datë 18 dhjetor 2017, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS kundërpërgjigjen në të cilën ajo i përsëritë pohimet e veta të cekura në mbrojtje në ankesë, ndërsa i kundërshton pohimet e paditësit të cekura në ankesë.

Me datë 12 maj 2022, shkalla e I-rë e DHPGJS-së lëshoi një Urdhër për paditësin, me të cilin kërkoi prova shtesë në mbështetje të ankesës, duke kërkuar vërtetimin mbi lartësinë e pagës mujore.

Me datë 24 maj 2022, paditësi e dorëzoi në DHPGJS një parashtresë si përgjigje ndaj Urdhrit. Në këtë parashtresë ai pohon se paga e tij mujore në kohën e largimit nga puna ishte 150 euro, ndërsa pohon se dokumentet lidhur me pagat gjinden në AKP. Me këtë parashtresë ai dorëzon provat që edhe më herët i kishte

dorëzuar, si dhe dorëzon fotokopje të Listës së pagave, Rekapitullim mujor të pagave.

Me datë 14 tetor 2022, shkalla e I-rë e DHPGJS-së e lëshoi një Urdhër për AKP-në, me të cilin është kërkuar nga AKP-ja që të deklarohet lidhur me provat që i ka sjellë paditësi.

Me datë 25 tetor 2022, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS një parashtresë si përgjigje ndaj Urdhrit. Në këtë parashtresë AKP-ja prap pohon se kërkesa për paga e paditësit është e parashkruar, pasi që ai nuk ka dorëzuar dëshmi që pagat në periudhën e cekur i ka kërkuar brenda tri viteve. Në këtë parashtresë AKP-ja nuk deklarohet lidhur me provat që i ka sjellë paditësi në gjykatë, e që ishte edhe kërkesë e urdhrit. Me këtë parashtresë AKP-ja ka sjellë një Rekapitulacion të pagave të datës 13.03.2010 dhe disa Urdhëresa pune të lëshuara nga NSH-ja në vitin 2010.

Me datë 11 nëntor 2022, shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-13-2081 e refuzon ankesën e paditësit si të bazuar, dhe e vërteton vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka arsyetuar se nga e paditura ka kërkuar që të sjellë në gjykatë Listën e pagave të punëtorëve për pagat e mbetura borxh, mirëpo në Listën e datës 29.07.2013, paditësi nuk ka qenë në listë. Tutje shkalla e I-rë konstaton se Njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës i datës 08 qershor 2012, nuk e ka ndërprerë parashkrimin e kërkesës, dhe se pretendimi i paditësit që ky Njoftim e ka ndërprerë parashkrimin është i gabuar. Tutje shkalla e I-rë konstaton se edhe nëse konsiderohet se Njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës i datës 08 qershor 2012, si veprim që e ka ndërprerë parashkrimin, në kuptim të nenit 392 të LMD-së, parashkrimi prap ka ndodhë, dhe përsëri kërkesa është parashkruar, pasi që kërkesa tek Autoriteti i Likuidimit është paraqitur me 16 korrik 2013, që është pas tri viteve, dhe kërkesa për paga në periudhën e cekur, është parashkruar në bazë të 372 paragrafi 1 të LMD-së, dhe atë që në dhjetor 2009. Andaj nga këto arsye ishte i drejtë dhe i bazuar në ligj vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 05 janar 2023, paditësi e dorëzoi në DHPGJS një ankesë të afatshme kundër Aktgjykimit të shkallës së I-rë të DHPGJS C-IV-13-2081 të datës 11 nëntor 2022, dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi të ankimuar dhe të aprovohet padia si e bazuar, ose lënda të kthehet në rigjykim. Për më tepër në ankesë paditësi ka pohuar se kërkesa e tij për paga të papaguara nuk është parashkruar, nga kjo arsye ishte i pa drejtë dhe në kundërshtim me ligjin Vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit. Tutje ai pohon se padia kolektive e punëtorëve lidhur me pagat e papaguara është regjistruar në gjykatë me 30 janar 2007, dhe kërkesa nuk mund të konsiderohet e parashkruar me 16 korrik 2013, kur është dorëzuar kërkesa tek Autoriteti i Likuidimit. Tutje paditësi në ankesë pohon se gjykata fare nuk i ka marrë parasysht Listat e pagave të dorëzuara nga ai, dhe se Aktgjykimi i ankimuar bie në kundërshtim edhe me Njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës. Paditësi pohon se Ligji mbi mardhëniet e punës i vitit 1989, nuk përmban institutin e parashkrimit të kërkesave monetare, dhe kjo duhet të merret në favor të ankuesit.

Me datë 20 mars 2023, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS përgjigjen ndaj ankesës së paditësit. Në këtë parashtrësë AKP-ja pohon se Aktgjykimi i Shkallës së I-rë është i bazuar në ligj dhe në prova, dhe se ky Aktgjykim duhet të vërtetohet nga Kolegji i Apelit. Tutje AKP-ja pohon se pretendimet e veta dhe argumentet ligjore në mënyrë të mjaftueshme i ka qartësuar në mbrojtjen në padi dhe në procedurat e mëvonshme, andaj përsëritja e këtyre argumenteve do të ishte e pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës. Nga këto arsye AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar, dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e paditësit është pjesërisht e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP) Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i shkallës së I-rë të DHPGJS-së, pjesërisht nuk është i saktë në rezultat, andaj ai pjesërisht duhet të ndryshohet, lidhur me pjesën e kërkesës për paga nga muajt mars 2004-dhjetor 2006.

Kolegji i Apelit vëren se Autoriteti i Likuidimit i NSH-së Industria e Baterive IBG në Gjilan (në likuidim) me vendimin GJI058-0054 të datës 13 shtator 2013, e ka refuzuar kërkesën e paditësit për kompensim e pagave të papaguara për periudhën dhjetor 2003-dhjetor 2006 në shume prej 3,790.00 euro si të pavlefshme, me arsyetimin se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Shkalla e I-rë e DHPGJS-së e ka refuzuar ankesën e paditësit dhe e ka vërtetuar Vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, për të njëjtën bazë ligjore.

Kolegji i Apelit nuk i mbështet konstatimet e gabuara të Autoritetit të Likuidimit dhe të shkallës së I-rë të DHPGJS-së se kërkesa për paga në periudhën e cekur tërësisht është parashkruar.

Nga Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Gjilan, C.nr.147/2007 të datës 14 prill 2011, vërehet se paditësi së bashku me punëtor tjerë të NSH-së e kanë dorëzuar në Gjykatën Komunale në Gjilan, një Parashtresë për plotësim të padisë kolektive, me datë 20 mars 2007. Me këtë parashtresë paditësi dhe disa punëtor tjerë kërkuan nga gjykata që të detyrohet NSH-ja të bëjë pagesën e pagave të papaguara për periudhën dhjetor 2003-dhjetor 2006. Paditësi me këtë parashtresë ka kërkuar shumën prej 3,790.00 euro, do të thotë të njëjtën shumë që e ka kërkuar edhe tek Autoriteti i Likuidimit.

Kjo padi kolektive ishte aprovuar në favor të paditësve nga Gjykata komunale në Gjilan me Aktgjykimin e cekur. Ndaj këtij Aktgjykimi AKP-ja ka paraqitur ankesë, ndërsa Kolegji i Apelit me Aktvendimin AC-II-14-0013 të datës 14 dhjetor 2016, e pezullon procedurën ankimore për shkak se ndaj NSH-së ka filluar procedura e likuidimit.

Duke marrë parasysh faktin se padia kolektive për paga është paraqitur me datë 20 mars 2007, atëherë delë që pagat nga muaji mars 2004 e deri në dhjetor 2006, nuk janë parashkruar, siç konstaton në mënyrë të gabuar Autoriteti i Likuidimit dhe shkalla e I-rë e DHPGJS-së. Ndërsa pagat nga muaji dhjetor 2003 e deri në shkurt 2004 janë parashkruar, dhe lidhur me këtë pjesë të kërkesës, pajtohet edhe Kolegji i Apelit, me konstatimin për parashkrim, të dhënë nga Autoriteti i Likuidimit dhe nga shkalla e I-rë e DHPGJS-së.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me ankesën e tij të dorëzuar në shkallën e I-rë të DHPGJS-së ka dorëzuar vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, kopjen e Librezës së punës e mbyllur me datë 22 maj 2012, kopjen e Letërnjoftimit, një kopje të Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Gjilan C.nr.147/2007 i datës 14.04.2011, dhe Njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës.

Ndërsa me parashtresën e datës 24 maj 2022, paditësi e dorëzoi në DHPGJS provat që edhe më herët i kishte dorëzuar, si dhe dorëzon fotokopje të Listës së pagave të muajit janar dhe nëntor të vitit 2003, si dhe Rekapitullim mujor të pagave për disa vite, në periudhën e cekur, por jo për të gjithë muajt në periudhën e cekur.

Duke u bazuar në këto lista të pagave të pa paguara, ku paga nuk ishte njëjtë në muajt që u përkasin këto lista, në periudhën e cekur është marrë si mesatare paga mujore e tij prej 90.00 euro. Këto lista të pagave, dhe as shuma e kërkuar nga ana e paditësit nuk kontestohen nga AKP-ja, as me mbrojtje në ankesë dhe as me parashtresën e AKP-së të datës 25 tetor 2022. AKP-ja kërkesën për paga e konteston vetëm për shkak të parashkrimit.

Në periudhën mars 2004-dhjetor 2006, janë 34 muaj, dhe kur kjo kalkulohet me pagën mesatare prej 90.00 euro, delë që NSH-ja i ka mbetur borxh paditësit për paga të papaguara në shumë prej 3,060.00 euro.

Andaj duke u bazuar në provat e cekura më lartë, paditësit i njihet e drejta në pagesën e pagave të papaguara në shumë prej 3,060.00 euro, për muajt mars 2004-dhjetor 2006, ndërsa në bazë të nenit 37.3 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, edhe interesi ligjor prej 10%, në shumë prej 306.00 euro, të cilat shuma do të paguhen nga e paditura, sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Bazuar në nenin 62.2 të LDHP-së, paditësit i njihet edhe e drejta e kompensimit të pagesës së taksës gjyqësore prej 30 euro për ankesën në shkallën e I-rë të DHPGJS-së, pasi që ai është pjesërisht është palë e suksesshme në këtë procedurë.

Prandaj nga se u tha më sipër, e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Në bazë të kërkesës për lirim nga pagesa e taksës gjyqësore të dorëzuar në DHPGJS me datë 20 janar 2023, dhe dëshmime mbështetëse të saj, paditësi lirohet nga pagesa e taksës gjyqësore për procedurën ankimore.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 11 janar 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues
